



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN100320230026

Tiranë, më 20.04.2023

Komisioni 44

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “Vlora Harbor Construction and Maintenance” Sh.p.k.

Nr. NIPT-i: M21806032P

Adresa e selisë: rruga “Bilal Sina”, zona kadastrale 3292, nr.pas 153/97+3-5, volume 43, faqja 8, Selitë, Tiranë

Personi përgjegjës: Hektor Agalliu

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit gur gëlqeror**”.

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Zona minerare Nr.384/1, Objekti “Radhimë”, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë.

Të dhëna teknike:

Sipërfaqe prej 0.092 km²

Lloji i mineralit: gure gëlqeror

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: Sugjerojmë që gjatë implementimit të projektit, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor si më poshtë: - Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; - Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; - Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.02.2005, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar; - Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar; - Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar; - Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B , si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ i ndryshuar; - Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”; - Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar; - Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas Parimit të Përgjegjshmërisë Ndaj Mjedisit, në përputhje të plotë me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin në mënyrë të integruar të mbetjeve.

Sektori i pyjeve vlerëson se në çdo rast duhet pasur parasysh zbatimi me rigorizitet i ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”, veçanërisht neni 12 i tij. o Sugjerohet që gjatë zhvillimit të aktivitetit, subjekti të mbajë në konsideratë legjislacionin në fuqi: - Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar; - Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar; - Ligji nr. 81/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura”; - Vendimt nr. 303, datë 10.5.2019 “Për Miratimin e Listës së Rishikuar, të Përditësuar, të Monumenteve të Natyrës Shqiptare. o Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së shfrytëzimit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme: - Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”; - Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”; - Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të

shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”. - Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”. o Sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit. Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve etj., të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit Gur Gëlqeror. Zona minerare Nr. 384/1, Objekti “Radhime”, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë”, me zhvillues “Vlora Harbor Construction and Maintenance” dhe aplikues “Vanina Latifi” me nr. Aplikimi AN100320230026, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë shprehet se Verifikimi në objekt për inspektimin e subjektit nga specialistët e Lejeve dhe VNM-ve për dhënien e mendimit për VNM u mbështet në Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjin Nr.10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Vendimin numër 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të dikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe akteve nënligjore mjedisore në fuqi, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë ngriti grupin e punës më datë 27.03.2023 për Subjektin: “Vlora Harbor Construction & Maintenance” sh.p.k me Aktivitet: “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit gur gëlqeror”, me Vendndodhje: Zona minerare Nr.384/1, Objekti “Radhimë”, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë. Qëllimi i projektit të propozuar nga subjekti “Vlora Harbor Construction & Maintenance” sh.p.k është shfrytëzimi dhe përpunimi i mineralit gur gëlqeror deri në produktin e gatshëm për shitje si inerte, etj., me objekt projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Portit të Integruar në Triport Vlorë. Shfrytëzimi do të bëhet me karrierë në zonën e kërkuar për shfrytëzim e cila ka një sipërfaqe prej 0.092 km², me kapacitet prodhimi 100 000 m³ /vit. Hapja e karierrës do të realizohet me shfrytëzimin sipërfaqësor i cili realizon lidhjen me transport automobilistik të prodhimit e zbulimit nga horizontet e punës në karrierë deri në vendin e përpunimit ose portin Triport. Gjatë funksionimit të këtij projekti për prodhimin e lëndës së parë (gur gëlqeror) do të përdoren materiale ndihmëse si lëndë djegëse për makineritë eskavatori, kamionat dhe lëndë plasëse për shkriërimin e mineralit. Ndikimet më të mëdha negative të këtij aktiviteti janë ndryshimi i peisazhit në një sipërfaqe prej 0.092 km² dhe humbje e strukturës së tokës. Aktiviteti që zhvillohet mund të shkaktojë rritje të shkallës së erozionit. Pjerrësia e terrenit mund të bëhet shkak që grimcat e tokës të ekspozohen ndaj agjentëve atmosferikë duke u shkëputur dhe lëvizur jashtë zonës së shfrytëzimit. Sugjerime: • Të bëhet menaxhimi i mirë i mbetjeve sterile dhe dherave që prodhohen gjatë fazës së zbulimit të mineralit gur gëlqeror. • Të evitohet efekti i erozionit. • Mbetjet inerte që do të gjenerohen të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" • Të bëhet sistemimi i dherave në tarracat e shesheve të shkallëve për të gjithë sipërfaqen që do të shfrytëzohet për të krijuar sipërfaqet për mbjellje, shkurresh ose barishtesh të zonës duke përmirësuar dhe peisazhin estetik. • Mbetjet sterile dhe inerte të ripërdoren për rehabilitimin e zonës së shfrytëzimit dhe për ndërtimin e një sërë

rrugësh të brendshme në zonën e karrierës. • Të përdoret ujë për lagjen e territorit në formë spërkatje për shmangien e pluhurave dhe këto ujëra së bashku me ujërat e shiut të grumbullohen në vaska dekantimi para se të derdhen në kanalet e zonës. • Të monitorohet niveli i zhurmave sipas Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedisë të caktuara.

Të zbatohet legjislacioni mjedisor në fuqi gjatë shfrytëzimit. • Territori ku kryhet aktiviteti minerar duhet të rrethohet me tabela paralajmëruese ku të tregohet për punimet që kryhen, rradhën e kryerjes së tyre. • Të kryhet rehabilitimi përfundimtar i shkallëve të karrierës, shesheve të karrierës, rrugëve jashtë karriere, shesheve të depozitimit të sterileve etj. • Të ruhet pjerrësia e brezit të shkallës në mënyrë që të ekzistojnë kushtet për mbulim të shkëmbit amnor. • Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit. • Subjekti duhet të zbatojë kushtet e VKM 315, dt. 5.5.2010, pika 2, paragrafi “a”; “Për procedurën e dhënies së Autorizimit, për përdorim civil të lëndëve plasëse” • Subjekti duhet të plotësojë parametrat e pashaportave përkatëse të shpim plasjeve. • Shpërthimet dhe plasjet me eksploziv të kryhen në orare të tilla që zhurmat të kenë ndikim minimal në zonën përreth. • Të llogariten distancat e rrezikshme nga përdorimi i lëndëve plasëse. • Të mbushen birat nga lëndët plasëse me amonit malor. • Të bëhet trajnimi periodik i punonjësve ku të njihen me rregullat e sigurimit teknik në kushte normale pune si dhe në raste avarish. • Të merren masa për parandalimin e rënies së zjarreve nga plasje, shpime, energji elektrike si dhe të sigurohet subjekti me mjetet e ndërhyrjes së shpejtë në rast zjarri (depozita uji, zjarrëfikëse e lëvizshme, etj., sipas projektit të mbrojtjes kundra zjarrit).

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye në datën 07.03.2023. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguroa të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. Kërkesat e pjesëmarrësve, do të mbahen parasysh, në fazën kur shoqëria do të fillojë procedurat për fazën e shfrytëzimit.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 44, datë 20.04.2023, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.75, datë 07.04.2023, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
- Shkrese Nr 5839/1 prot., datë 18.10.2022 “Mbi aplikimin për Leje Minerare Shfrytëzimi për zonen Nr 384/1, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me subjektin “Vlora Harbor Construction and Maintenance” Sh.p.k., për objektin “Projektimi, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e “Portit të Integruar” në Triport, Vlorë”.
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- 4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.4 **Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.** Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.
- 4.5 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të vecantë.

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.7 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 **Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësi vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkakuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.

- 4.20 Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.**
- 4.21 Personi përgjegjës teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.**
- 4.22** Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.23** Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.24** Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.25** Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.26 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.**

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodi citeti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	22.10.2023	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	22.10.2023	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	22.10.2023	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.

- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	22.10.2023	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	22.10.2023	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodicite ti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	22.10.2023	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- Afati i Vlefshmërisë

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Harta me Koordinatat (sipas MIE)

